


Interviste me peotin pogradecar Dhimiter Pojanaku

Ligësia e të mençurve, thikë nën mantel

Vite më parë, kur zëri i tij u ndje në kryeqytet, Tirana ishte më e dashur me poetët e rretheve. Sot nuk është edhe kaq e thjeshtë. Ndonëse me disa vëllime të botuara dhe disa çmime kombëtare e ndërkombëtare në Francë, Itali, Greqi, Maqedoni etj., poeti Dhimiter Pojanaku e ndjen peshën e gjuhëgjatëve dhe helmeve të të liqve. "Tek artistët ke dy lloj ligësish, ligësia e dështakëve, që i shohin ata që ecin para me mllef e çfarë nuk shpikin, dhe ligësia e atyre që janë në shkëlqim dhe nuk duan tjetër t'u afrohet, pale po t'ua kalojnë pak, bëhen si ujçer apo ujkonja. Zoti na ruajtë nga të gjitha ligësitë...", thotë Pojanaku, i cili në vitin 2003 ka merituar çmimin e ndarë nga MTKRS, "Penda e argjendtë" për poezinë më të mirë. Ka botuar vëllimet "Shiu lexon trishtimin tim", "Mëngjes dhe pak natë", "Xhindet kërcëjnë polka", "Gurët zbardhin natën" dhe "Shtëpia ime rrotullon qiellin".



**Lamtumirë,
prokuror
Xhevat Hana!**



**Kufoma e
Malit të Thatë**
Nga Bedri BLOSHMI

**Një histori që
nuk e shuan
as koha**

"GRINATA", LIBRI MË I RI I ISTREF HAXHILLARIT MESDITË QYTETARE KULTURORE NË POGRADEC



Kështu e kishte konceptuar fundjavën në qytetin turistik të juglindjes, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të qarkut të Korçës, bashkëbisedim për letërsinë e artin, sidomos rreth librit me tregime të botuar kohët e fundit nga Istref Haxhillari, poezi e këngë nga grupi i këngës qytetare "Nostalgjia Pogradecare" dhe vere, sa shume vere dhe ato që e shoqërojnë atë nga arti i kuzhinës së këtij qyteti. Kjo duket se i zhveshi nga emocionet e droja edhe miqtë e ardhur nga Durrësi, Tirana, Elbasani e Korça, sidomos poetët për të recituar krijimet e tyre, por edhe për të folur rreth nivelit që shënon në letërsinë tonë edhe proza e kolegut të tyre Istref Haxhillari, me vëllimin e ri me tregime të titulluar "Grinata", botuar nga "Uegen" Tiranë, por edhe për probleme të tjera të letërsisë dhe arteve sot në vendin tonë. (2)

"Verë 2012 performance deejay", spektakli i shumëpritur, në Pogradec

Emra të njohur e të panjohur të deejay-ve shqiptarë do të jenë pjesë e këtij spektakli nën moton: "Të elektrizojë spektatorin shqiptarë me muzikën që do të luajnë". Producenti Guga e stafi i tij premtojnë netë të paharrueshme për të gjithë spektatorin e telespektatorin që do të ndjekë "Verë 2012 performance deejay"



Selca e Sipërme me histori të shkruar

**PROMOVIMI I LIBRIT
"SELCA E SIPËRME,
MOKËR MONOGRAFI,, E
AUTORIT DAUT KROI**

**GJERGJ PEKMEZI,
PERSONALITET
I SHQUAR**



Lamtumirë, prokuror Xhevat Hana!

Pas një mjekimi disa ditë më 5 janar 2012 në një spital në Bergamo të Italisë, nga një sëmundje e rëndë u nda nga jeta në moshën 59 vjeçare, prokurori Xhevat Hana. Xhevati lindi në fshatin Rrajcë të rrethit Librazhd më 28 mars 1953.

Pasi u arsimua në të gjitha nivelet, me rezultate shumë të larat, filloi karrierën e tij në organet e akuzës të Rrethit Mat, dhe më pas ka ushtruar detyrën me përkushtim në Sarandë e në Tiranë deri në nivelet e larta në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të Krimeve të Rënda.

Në periudhën 2003-2005 ka punuar si këshilltar juridik i Presidentit të Republikës, zotit Alfred Moisiu, si dhe ndimës komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit. Ka hetuar disa çështje të cilat kanë të bëjnë me ngjarjet e vitit 1997, në Vlorë, e shumë dosje të tjera të rëndësishme, e më pas në prokurorinë e Përgjithshme.

Xhevat Hana është karakterizuar si një prokuror i përkushtuar, kurajoz, këmbëngulës në



detyrën e tij.

Më 9 janar 2012 trupi i tij i pajetë mbërriti në aeroportin e Rinasit dhe me qindra kanë qënë kolegët, miqtë, e të afërmit, por edhe qytetarët të cilët më 10 janar 2012 i dhanë lamtumirën e fundit.

Në nderim të tij bëri homazhe, Presidenti i Republikës zoti Bamir Topi, Prokurorja e Përgjithshme, Ina Rama,

ish Presidenti Republikës Zoti Alfred Moisiu, kolegë të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Prokurorisë së Tiranës dhe nga Prokuroritë e rrethëve të vendit. Në respekt të Xhevat Hanës kishin ardhur me dhjetra banorë nga vendlindja e tij Rrajca e Prrenjasi për të cilën Xhevati i ka dashur dhe respektuar gjatë gjithë kohës. Pjesë-

marrësit në cermoni janë përkulur me nderim pranë trupit të prokurorit që la gjurmë dhe emër në historinë e organit shqiptar të akuzës. Në ambientet e Qendrës Kulturore të Forcave të Armatosura në Tiranë, u bënë homazhe në nderim e vlerësim të veprimtarisë e kontributit profesional të Prokurorit të Krimeve të Rënda, Xhevat Hana.

Largimi nga jeta, në këtë kohë i Xhevat Hanës, është një humbje e madhe, e rëndë. Ai lë një vend të madh vakant në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ku mbronte akuzën në emër të shtetit, lë pas një histori të pazakontë.

Fikja e prokuror Hanës, ishte një ikje e natyrshme, e parakohëshme, përpjekjet për të ndaluar ikjen nga jeta, qenë të mëdha e të plota nga bashkeshortja Dhimitra e cila bëri të pamundurën, vajzat që i donte jashtë mase, djali Rezarti të cilin e edukoi me ndjenjat e dashurinë për profesionin e drejtësisë. Hidhërim të madh ikja e Xhevatit la tek Babaj, Tahiri, nëna, vëllezrit, motrat e

gjithë fisi. Përpjekje të mëdha u bënë edhe nga të afërmit e tij, po ja që sëmundja e rëndë, e shpejtë nuk e la të jetonte, po na e mori shumë shpejt, kjo ikje na duket si një ëndërr, kjo me dëshirën që ju keni ikur fizikisht o nderuari Xhevat HANA, por nuk keni ikur dhe nuk do të harroheni kurrë nga zemrat dhe kujtimet e gjithë dasha[mirsëve të t'u. Të gjithë ne do t'ju kujtojmë, se ju keni lënë pas veprën tuaj të një pune të ndershme dhe dinjitoze., keni lënë njerzit e t'u të dashur .

Ah kjo ditë e zezë ku të gjithë ne po ndahemi me ju prokuror, ne të thamë Lamtumirë prokuror Xhevat....

I pa harruar qoftë kujtimi Juaj. Përfitoj nga rasti që nëpërmjet gazetës "Mokra", dhe shoqatës "Pelioni" t'u shprehim ngushëllimet familjes, miqëve, fëmijëve dhe gjithë dashamirësve të prokuror Xhevatit. Pushoftë në paqe shpirti i tij. I qoftë e lehtë toka dhe i pa harruar emir.

Zabit CUKU
Nënkrjetar i Shoqatës
"Pelioni"


"Grinata", libri më i ri i Istref Haxhillarit

Vëllimi me tregime do të promovohet më 28 janar në Pogradec

Autori vjen pas disa eksperiencash në fushën e prozës së shkurtër dhe të gjatë. Por në dalim prej tyre, Haxhillari mbërrin tani me një vizion të filtruar e konçiz. Tregimi i tij bëhet i zhërvjellët, me ndërthurje të dinamizmit të jashtëm dhe të brendshëm, madje ky i fundit herë herë të krijon idenë se je mbi dallgë që shkojnë, shkojnë, vijne...

Leximi bën të "shpërthesh emocionalisht", edhe pse ndjesitë janë të fshehura. Në prozat e librit "Grinata" koha dhe vendi na çojnë drejt eksplorimit të vetvetes duke përsiatuar rreth natyrës, historisë, krijimit të universit, ndikimit të botës tek ne, përditshmërisë sonë të cunuar, të plotë, reale, imagjinare, të kapshme, fluide - gjithçka përbën të tërën, përcjellë përmes një optike rrëfimore.

Të organizuara nga qëndrime të thjeshta, Haxhillari na fton të ngrihem kundër vlerave të kota dhe meskinitetit, prej kohësh dominuese në shoqërinë tone, na le të lirë të meditojmë rreth ngjarjeve të pasqyruara saktë me mjete të kursyera, të cilat e përforcojnë statusin e tyre duke u bërë thellësisht metaforike. Nganjëherë përmes rreshtave lexojmë gati-gati një poezi të mirëfilltë lirike. Ky "shpërthim i fshehtë ndjenjash" e bën prozën e Haxhillarit krejtësisht intime, na çon butësisht tek thelbi, që nuk gjendet në temën e tregimit, por në subjektin e shprehjes duke sh-



kuar natyrshëm përtej kufijve personalë. Loja me mjetet e kursyera leksikore, njëherazi origjinale, si vetë titulli i vëllimit "Grinata"- gri/nata/- e jo muzg sikurse e njohim, të çon menjëherë në regjistrin lirik të të konceptuarit dhe të shprehurit. Përveç kuptimit semantik kjo kompozitë ka përmbajtje të fortë simbolike si lajtmotivi i gjithë vëllimit: jeta njerëzore gjallon mes grisë (të bardhës e të zezës!) dhe natës. Lojën me simbolikën e ngjyrave që i përshtatet aq shumë këtij realiteti, ia ofron vetë jeta.

Në përfundim të leximit ndjen se e ke shtuar numrin e miqve të tu, qofshin këta edhe personazhe...!

Mimoza EREBARA

Ky libër është oaz me ujë të freskët e të kulluar, ku shijon gjithë ngjyrat e jetës. Duket sikur autori e ka ngjyer penën në një mjedis magjik e të pakohshëm. Nganjëherë më ngjan se kam në dorë një send prej kristali dhe druhem mos më bie e thyhet...

Petra Zoto, Tiranë.

Proza e Haxhillarit u ruan trojet e merituar përshkrimeve të natyrës, tipareve njerëzore, trandjeve shpirtërore, habive, pyetjeve dhe mospërgjigjeve, duke ngjizur një kohë të vetvetishme...

Dr. Ardian Christian
Kyçyku, Bukuresht.

Tregimet shquhen për gjuhën lirike, përshkrimin piktoresk të natyrës dhe gërshtimin emocional me karakteret njerëzore. Lirizmi dhe epizmi janë shkrirë së bashku në këto rrëfenja të mrekulueshme të ditëve të sotme...

Vangjush Ziko, Kanada.

Është brerore e artë e autorit, një libër që do të qëndrojë gjatë, thjesht e krenar, para mijëra shokëve të tij, stivosur radhë-radhë nëpër biblioteka...

Dhimitër Pojanaku, poet,
Pogradec.

Autorin e quaj pa mëdyshje një natyral të fjalës artistike...

Anastas Kostandini,
"Piktori i merituar", Pogradec.

MESDITË QYTETARE KULTURORE NË POGRADEC

Kështu e kishte konceptuar fundjavën në qytetin turistik të juglindjes, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artisteve të qarkut të Korçës, bashkëbisedim për letërsinë e artin, sidomos rreth librit me tregime të botuar kohët e fundit nga Istref Haxhillari, poezi e këngë nga grupi i këngës qytetare "Nostalgjia Pogradecare" dhe vere, sa shume vere dhe ato që e shokërojnë atë nga arti i kuzhinës së këtij qyteti. Kjo duket se i zhveshi nga emocionet e droja edhe miqtë e ardhur nga Durrësi, Tiranë, Elbasani e Korça, sidomos poetët për të recituar krijimet e tyre, por edhe për të folur rreth nivelit që shënon në letërsinë tonë edhe proza e kolegut të tyre Istref Haxhillari, me vëllimin e ri me tregime të titulluar "Grinata", botuar nga "Uegen" Tiranë, por edhe për probleme të tjera të letërsisë dhe arteve sot në vendin tonë.

Duke vlerësuar krijimtarinë më të mirë letrare të këtij autori, nga kolegët e tij u vu në dukje se, Haxhillari ka fatin e dhjetra poetëve dhe shkrimtarëve të degjuar, frymëzimin e të cilëve e ka

ushqyer vendlindja e tyre, Korça e Pogradeci, që ai jo rastësisht e ka shënuar në fund të tregimeve të veta. Dhe edhe pse lëndën e ka të pasur, si një piktori të kursyer në ngjyra, i mjafton minimalja e tyre, për të portretizuar personazhet e veta me dritëhijet dhe luhajtjet e shpirtit të tyre.

Lirizmi që e përshkon prozën e tij është si një fill i artë që stolis këtë shpirt, pas anatomisë që i bën, me një bisturi thuajse të padukshme, ku ndihet forca e ligjërimit dhe ndikimi estetik i parerëndësve të tij të famshëm, por kërkimi në fatin "e pa shkruar të heronjve të këtij libri, fjala e përkushtuar, gjallëria e ritmi i kohës, struktura dhe sistemi shprehës i qëlluar i rrëfimit", e përvijojnë Haxhillarin si një individualitet të ardhshëm letrar, u tha nga të pranishmit.

Java tjetër?... "Surprizën e kemi ne, thotë Piktori i Merituar, Anastas Kostandini, me një ekspozitë mjaft interesante që do të çelëm, në Galerinë e Arteve të Shtëpisë së Kulturës "Lasgush Poradeci". Ja pse është i pasur edhe tani në dimër pushimi i fundjavës në Pogradec".



Faleminderit që më lehtësuat dhimbjen!



Jeta është e bukur dhe e larmishme. Ajo shoqërohet me gëzime të shumta familjare, si lindjet, fejesat, martesat, me festa të ndryshme shoqërore, fetare etj, duke i dhënë njeriut një kënaqësi të ligjshme. Por, veç kësaj jeta ka edhe anën tejtër, që janë fatkeqësitë e ndryshme natyrore, shëndetësore e deri tek ndarjet përfundimtare nga jeta. Në fundin e vitit që lamë pas, mbas një sëmundjeje të rëndë u nda nga jeta bashkëshortja ime, me të cilën kishim një gjysmë shekulli

që na bashkonin të mirat dhe sakrificat që na dolën para. Me këtë rast dëshiroj të falenderoj kryesinë e shoqatës "Pelinoi", redaksinë e gazetës "Mokra", shokët, miqtë të afërmit, si dhe gjithë bashkëfshatarët e mi mokrarë, që me praninë, telefonatat dhe mesazhet e tyre ma lehtësuan në maksimum hidhërimin që më ra, një traditë kjo me shumë vlera që trashëgohet brez pas brezi në zonën tonë të Mokrës. Ju faleminderit!

Me respekt Pëllumb ZADE

MBETJET INERTE, PROBLEM PËR NDOTJEN DHE RRUDHJEN E BREGUT TË LIQENIT TË OHRIT

Pellgu ujëmbledhës i liqenit të Ohrit përmbledh rreth 40 lumenj e përrenj, 23 prej të cilëve ndodhen në territorin e Shqipërisë dhe 17 në atë të Maqedonisë, por pjesa më e madhe e tyre shterojnë gjatë verës dhe janë të papërfillshëm përta i takon prurjes së tyre në liqen. Duke patur parasysh reshjet vjetore në këtë rajon, me një mesatare vjetore, sipas shërbimit meteorologjik, prej 760 mm, del se prurjet në liqen janë të barabarta me 2,81 l/ sek. Kështu, duke llogaritur edhe prurjet e mëdha nga burimet nënujore uji qëndron relativisht në basenin ujëmbledhës, derisa ndërrohet plotësisht, për një periudhë prej 60 vjetësh.



Por, këta lumenj e përrenj bashkë me ujin, sjellin në liqen, sidomos gjatë dimrit edhe prurje të ngurta e mbetje urbane, të cilat jo vetëm ndotin ujrat e tij, por moçalizojnë dhe mbathin një pjesë të bregut. Kritike paraqitet sidomos gjendja jo vetëm nga hedhja e mbetjeve urbane të banorëve të komunave Hudënisht e Buçimas, në lumenjtë e përrenj që derdhen në liqen, por edhe ato të gurorëve që zhvillojnë aktivitet në masivet shkëmborë të bregut liqenor, mbetjet që krijohen nga veprimtaria e firmave të ndërtimit, ato të ish-fabrikës së pasurimit të hekur nikelit në Gur të Kuq, të ish-stacionit të mallrave në Mëmëlisht si dhe ato që i çojnë me qëllim për të zgjeruar sipërfaqet që kanë në përdorim bizneset që operojnë në vijën e liqenit. Disa prej tyre kanë betonuar bregun, në një gjatësi prej rreth 4 km dhe kanë ndërtuar ura dhe platforma shërbimi brenda në liqen, duke dëmtuar ekosistemin e tij.

Shembulli më i keq se ç'mund të ndodhë është Prespa e Vogël, ku vite më parë, për ta përdorur basenin e saj ujëmbledhës për ujitjen e fushës së Korçës, nëpërmjet kanalit të Vëntroikut, futej gjatë dimrit rrjedha e lumit Devoll, i cili me prurjet e tij të ngurta, mbathi liqenin, duke e kthyer atë në një moçalishte ku sot rritet kallami. Shtimi spontan i kësaj bime ujore edhe përgjatë bregut të liqenit nga Lini në Tushemisht, është paralajmëruesi më i mirë nga ana e natyrës, se ç'mund të ndodhë në një të ardhme të largët. Zhvillimi i turizmit sot e në të ardhmen në Pogradec është i lidhur vetëm me mbrojtjen e liqenit të Ohrit.

Më problematikë janë lumi i qytetit Pogradec, lumi i Tërhanit, ai i Vërdovës, i Çërravës, në rrjedhën e të cilëve nuk shikon as kaskada ku mund të sedentojnë një pjesë e mbetjeve të

"Verë 2012 performance deejay", spektakli i shumëpritur, në Pogradec

Emra të njohur e të panjohur te deejay-ve shqiptarë do të jenë pjesë e këtij spektakli nën moton: "Të elektrizojë spektatorin shqiptarë me muzikën që do të luajnë". Producenti Guga e stafi i tij premtajnë netë të paharrueshme për të gjithë spektatorin e telespektatorin që do të ndjekë "Verë 2012 performance deejay"

Sapo ka përfunduar edicionin e 3-të të konkursit të vetëm Kombëtar në Shqipëri për deejay. Pasionanti, ideatori e producenti Sokol Guga nisi menjëherë punën për edicionin e 4-të të këtij konkursi. Guga e di mire se edicioni i këtij viti do shumë punë, shumë energji e përkushtim, pasi ky vit do të jetë ndryshe, në të gjithë strukturën artistike, por ajo që mbetet e njëjtë me vitet e kaluara është vetëm performanca e konkurenëve në hapësirën kohore prej 10 min, ku secili konkurrent do të shpalosë aftësitë e tij individuale.

Edicioni i 4-të i "Verë 2012 performance deejay" do të realizohet në tre netë magjike, ku dy netë do të jenë gjysëm-finale dhe nata e tretë do të jetë finalja e madhe e cila do të mbahet në qytetin e bukur të Pogradecit.

"Ndryshe nga vitet e tjera, konkursi do të mbledhë në konkurim rreth 30 deejay profesionistë nga e gjithë Shqipëria, të cilët do të ndahen në dy grupe, 15 Konkurent natën e parë e 15 konkurentë natën e dytë", - shprehet njëri prej anëtarëve të stafit.

Nga dy netët gjysëm-finale do të përzgjidhen rreth 6 konkurrentë ku do të prekin skenën e natës finale për 10 çmimet që produksioni organizativ ka vendosur në dispozicion për konkurrentët deejay.

Votimi është kreu transparent, pasi konkurrentët do të votojnë për njëri-tjetrin si në natën e parë ashtu dhe të dytë, si dhe në natën e tretë, për të shpallur fituesin, duke shmangur kështu të gjitha polemikat që mund të ndodhin me stafin organizativ.

Konkurrentët do të votojnë për çmimet:

Çmimi i parë "Verë 2012 performance deejay", çmimi "Internetit", çmimi "Televiziv", çmimi i "Produksionit Organizativ", çmimi "Produksioni muzikor më i mirë" e deri tek çmimi për konkurrentët që janë për herë të parë e më të rinjtë në moshë, çmimi "Best Jang Deejay"

Producenti Sokol Guga, shprehet se "ky event, i kthyer në traditë tashmë do të sjellë risi, jo vetëm për faktin se do të zhvillohet në 3 netë ku tejkalo-

hen hapësirat kohore televizive të konkursit në një transmetim për rreth 4 orë, por stafi ka menduar që eventi i këtij viti të shoqërohet nga kalendari 2012, ku



secili konkurrent do të jetë pjesë e këtij kalendari, por jo vetëm është menduar të shfaqet për të gjithë të apasionuarit e muzikës elektronike si dhe për të gjithë ata fansa të këtij spektakli, dy volume në cd, ku do të jenë miksimit më të mira të 30 konkurrentëve pjesëmarrës.

Emra të njohur e të panjohur te deejay-ve shqiptarë do të jenë pjesë e këtij spektakli nën moton: "Të elektrizojë spektatorin shqiptarë me muzikën që do të luajnë".

Stafi ka kohë që ka filluar nga puna. Fotografi Andis Rado do të kujdeset për setin fotografik të spektaklit, si dhe të kalendarit të këtij edicioni. Nën prezantimin e balet-maestrit Luixhino Hala, prezantues edhe i edicionit të kaluar, i cili do të kujdeset për ecurinë e mbarëvajtjen e programit, koordinatore Produksioni Romina Hala, e cila qëndron gjithnjë mbas producentit Guga,



në çdo sipërmarrje të tijën. Pjesë e ekipit të punës janë Ketrina Gjermani, Eda Haxhiu, Elis Brahim, Lerdj Jupaj, si dhe InNordine Alex si dhe në timonin e këtij produksioni qëndron Sokol Guga.

Producenti Guga e stafi i tij premtajnë netë të paharrueshme për të gjithë spektatorin e telespektatorin që do të ndjekë "Verë 2012 performance deejay"

Redaksisë së gazetës sonë të dashur

<< MOKRA >>

(Shkruesve e lexuesve te saj)

*Te dashur mokrare,
te ditur e bujare,
na ofte Vit' i mbare!
Shendet edhe gezime,
uroj nga zemra ime!
Punembare e gezimshume,
paci ju e paca une!*

Festofshim se bashku e te gezuar 100-Vjetorin e Pavarësisë Kombetare!

Ju perqafoj me dashuri e mall, Xhevahir Shtupa.
Pogradec me 29.12.2012

Kryeredaktor; Flori SLATINA
Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI,
Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"
Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës
Zenun FERRO, sekretar i shoqatës
Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:
www.pogradeci.com/mokra

Pojanaku: Ligësia e të mençurve, thikë nën mantel

Vite më parë, kur zëri i tij u ndje në kryeqytet, Tirana ishte më e dashur me poetët e rretheve. Sot nuk është edhe kaq e thjeshtë. Ndonëse me disa vëllime të botuara dhe disa çmime kombëtare e ndërkombëtare në Francë, Itali, Greqi, Maqedoni etj., poeti Dhimitër Pojanaku e ndjen peshën e gjuhëgjatëve dhe helmeve të të liqve. “Tek artistët ke dy lloj ligësish, ligësia e dështakëve, që i shohin ata që ecin para me mlllef e çfarë nuk shpikin, dhe ligësia e atyre që janë në shkëlqim dhe nuk duan tjetër t’u afrohet, pale po t’ua kalojnë pak, bëhen si ujçër apo ujkonja. Zoti na ruajtë nga të gjitha ligësitë...”, thotë Pojanaku, i cili në vitin 2003 ka merituar çmimin e ndarë nga MTKRS, “Penda e argjendtë” për poezinë më të mirë. Ka botuar vëllimet “Shiu lexon trishtimin tim”, “Mëngjes dhe pak natë”, “Xhindet kërcëjnë polka”, “Gurët zbardhin natën” dhe “Shtëpia ime rrotullon qiellin”.

Si u drejtuan hapat tua ja në rrugën e letërsisë dhe pse zgjodhët poezinë?

Nuk e di se si rashë brenda këtij kurthi sa të rrezikshëm, aq të bukur. I vogël kisha dhuntinë t’i mësoja përmendësh vargjet shumë shpejt. Duket kjo më ushëqeu dëshirën për të shkruar. Hapat e para kanë qenë ato të shkollës tetëvjeçare, klasa e katërt a e pestë. Shkollat bënin konkurse poetike ahëre dhe nxitin breza talentesh. Kampi i pionierëve Durrës më dha çmim të parë në një konkurs poetik dhe aty nisën “fluturimet” e mia poetike prej vërteti. Nuk e zgjodha poezinë, më erdhi nga Zoti. Poezia është vuajtje, dhimbje! Zoti e pat vënë re që unë e pëlqej vuajtjen, e ushëqej, e fisnikëroj, ndaj edhe ma solli poezinë!




Cila është bota juaj?

Qyteti im është i veçantë. Jeta këtu është e veçantë, provincë, por qyteti romantik e lezeton. Është mësuar me poetë. Përsëndetjet ndaj meje tashmë janë: “Ç’kemi poet, ndonjë poezi të re?”. Këtë e bëjnë më të shumtit. Ka edhe njerëz të vegjël, smirëzinj, por unë falë edhe profesionit, i kuptoj shpejt dhe u rri larg. T’u përgjigjesh helmeve të tyre, do të thotë të bësh harakiri nga qejfi i tyre dhe budallallëku jot. Jo, këtë nuk e kam bërë dhe nuk do e bëj. Ziliqarët nuk do më gjejnë asnjëherë në rrjetat e tyre. Boritë e tyre do i dëgjojnë gjer në shurdhim vetëm veshët e tyre, të mijtë asnjëherë! Familja ime është Adeline, e cila është jo vetëm një bashkëshorte e nënë e veçantë, por edhe një liman për stuhitë, që jeta ime i ka pasur dorëlëshuara.

Prindërit e saj kanë pasur origjinë greke dhe ajo ka trashëguar një kulturë të gjithanshme. Fëmijët e mi, edhe pse të rritur tashmë, mbeten dobësia ime. Vajza Eris dhe djali Pjer, janë pjesa më e rëndësishme e jetës sime. Kur ishin të vegjël, gëzimet që më sillnin ishin pa fund, aq sa nuk doja të rriteshin. Tani u rritën, kaluan adoleshencën, thuhet u poqën, por tani shqetësimet, problemet janë pa fund, jeta e tyre e re përballë realitetit shqiptar është aq e vështirë... Uroj të kenë rrugë të bardha... e keqja t’u rrijë sa me larg dhe të mos u afrohet.

Shumë poezi tuajat kanë lidhje me detin edhe pse jetoni kilometra të tëra larg. Ju jetoni pranë liqenit të bukur të Ohrit dhe “vdismi” për detin, përse?

Detin e kam dobësi. Nga vjen lidhja ime me detin, pyesni? Nga



Takimi “Me Pojanakun në Manhattan” (Ramiz Gjini, Justina aliaj, Dh. Pojanaku, Naum Prifti)

kraharori ndoshta, nga zemra, nga gjaku, ajri, hapësira...

Lidhja vjen nga syri që më kërkon det, oqean. Ku ka si deti! E dua edhe kur është i qetë si vaj edhe i egër, e kam të vetmin tempull ku rrëfhem. Kur më keni takuar në Vlorë nuk u kam thënë krejt të vërtetën, vij kryesisht për detin. Askush si ai nuk m’i kupton brengat dhe gëzimet.

Punoni në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ndodh të “ndërrhyjë” gjyqësori te poezia?

Duhet t’u them se poezia tek unë ka qenë e lindur, gjyqësori erdhi tepër vonë, pra ai e gjeti “kështjellën e ngritur”. Për çudinë time, jo vetëm që gjyqtari nuk e prishi magjinë, por përkundrazi i dha asaj ç’mund t’i jepte. Mori nga nenet gjuhën koncize, pa teprime, dhe ia fali poezisë. Ç’doja më tepër?

Ku zënë fill poezitë tuaja?

Tek gjithçka, një i dehur që mbyllet në fund të gotës, një gjetë i verbër, hëna e ngrënë nga vetmia... Më frymëzojnë udhëtimet, dëshpërimi dhe gëzimi. Muzika më ngre muzat nga gjumi. Kur fabula e poezisë merrret nga jeta dhe ke magji në çastin kur vjen, krijohet një poezi që e kalon cakun e kohës.

Mes vargjeve tuaja, kë keni më

shumë për zemër dhe cila është ajo që të tjerët pëlqejnë më shumë?

“Zhvirgjerimi i murgut”, “Loti i burrit”, “Dhoma përballë times”, janë disa poezi që lexuesit e poezisë sime i dinë edhe përmendësh dhe i recitojnë edhe pa praninë time. Sa për mua, më pëlqen cikli i poezive të vdekjes.

Ç’ju tërheq kah vdekja?

Vdekja është qasur shumë herë brenda fisit tim. Dhimbjet që më ka sjellë më kanë dhënë fisnikëri si mua, ashtu edhe poezisë sime. Poezitë e vdekjes morën jetë tek unë atëherë kur me ardhjet e saj të shpeshta kuptova se jeta e vdekja nuk bëkan pa njëra-tjetrën.

Kuptova se në vend që të grindem e zihem me vdekjen, “duhet të shkoj me tepër në kopshtin e saj/ Të ujit eshtrat e fisit tim”.

Po shkruani ndërkohë?

Një libër të ri, një botim në Greqi e Maqedoni, pasi jemi afër dhe duhet të njohim njëri-tjetrin. Tani për tani nuk do marr pjesë në konkurrimet poetike, nuk e di përse, kështu më thonë trillet... Konkurse poetike ka me dhjetëra, juritë kudo janë subjektive, edhe kur më vlerësojnë mua. Rëndësi ka të shkruash poezi që sfidon kohën. Ka shumë shkrimtarë që edhe pse nuk kanë

rrokur “Nobel”, mbeten të kërkuar tërë jetën, brez pas brezi. E ç’rëndësi ka çmimi ahërë?!

Kam lexuar diku një poezi tuajën për njerëzit e liq, keni njohur kaq shumë të tillë në rrugën tuaj?

Ligësia është më e keqja që has njeriu në jetë, sidomos artisti.

Të jesh thjesht i lig nuk bën aq zarar, sepse lexohesh lehtë. Kur je edhe i mençur edhe i lig, atëherë ligësia fshihet bukur, si thika nën një mantel të mëndafshhtë dhe jo se bën gjëmën, por të lëndon në mënyrën më të paskrupullt. Tek artistët ke dy lloj ligësish, ligësia e dështakëve, që i shohin ata që ecin para me mlllef e çfarë nuk shpikin, dhe ligësia e atyre që janë në shkëlqim dhe nuk duan tjetër t’u afrohet, pale po t’ua kalojnë pak, bëhen si ujçër apo ujkonja. Zoti na ruajtë nga të gjitha ligësitë... Poezia që ju keni lexuar te “Fjala e lirë” ishte për një lloj nga ligësitë e artistëve mesatarë, që nuk duan të shkëlqesh, je apo nuk je brenda

zhanrit të tyre krijues, p.sh. një këngëtar i njohur nuk do të shkëlqejë një poet, një poet nuk do të shkëlqejë një prozator, përse do thoni ju, sepse ligësia ua ka bërë zemrën gur, ja perse...

Kjo do të thotë se duke qenë edhe nga një vend i vogël nuk ka qenë e thjeshtë që të bëni emër, apo të merrni në vitin 2003 çmimin prestigjioz “Penda e argjendtë” për librin më të mirë në shqip...

Nuk them se ka qenë e lehtë. Por në kohën kur fillova të ndjehem në poezi, metropoli nuk ishte aq gllabërues, linte hapësirë edhe për krijuesit e rretheve. I kam zënë këto hapësira me mund dhe falë njerëzve të kryeqytetit që e donin poezinë time. Pastaj përmendim edhe faktin që Pogradeci është parë dhe shihet si qyteti i lirikës shqiptare dhe si qytet i pritshëm për befasi, sidomos në poezi dhe pikturë. Tani është ndryshe. Tani metropoli, krahas vlerave, është mbushur edhe me pseudovlera, të cilat për çudi ushqehen edhe nga ekranet e shumta televizive. Kjo është më e vështirë për artin në grup, si teatër, balet etj. etj. Këtu lulëzimi i antiverave sjell dëme të mëdha.

Intervistoi:
Enrik MEHMETI

Cikël poetik nga DHIMITER POJANAKU

Në pyjet e dendur

Çoje natën në pyjet e dendur miku im,
Kur të zhveshë të linjtat,
Tok
Me pyllin,
Dridhu e dehu nga bardhësia e saj prej qumështi.
Sidomos atje
Ku ditën fsheh !
Përkedhelja tekat,
Zbutja kapriciot,
Ruaje nga leopardi I pabesë.
Nëse i bën të gjitha përmrekulli miku im,
Nesër,
Mëngjesi,
Do ketë fityrën tënde !

Qiriri i lutet nates

Afromi faqet krahë korbash,
T'i zverdh e ngror me timin pjalm !

Përse trembesh ,
Vetëm unë di të digjem për ty me trup e eshtra.
Në jakën e palltos
Do ta stampos puthjen time
Si karafil i kuq
Gati per sherr,

Eja flutur bije serrash,
Më duaj,
Pa babëzi,
Palcën e perit ,

mos ma thith

përnjëherë,

Eja ta bëjmë ngadalë
Si,
motmoteve ,
moj skilja ime e vjetër

Pas dashurie
Ta dish,

Do krekosem

Si zambak i verdhë mbi lëkurën e deteve të zinj.

Depresion 2

E mbylla dritaren që binte nga rruga,
Me tulla

Tull pas tulle,
Rruga vidhej,
Përsillej dhomes si kone e braktisur,

Mos e mbyll!

Tulle pas tulle ,
Qielli krijonte plasa shpëtimi.

Drita e ditës,
Duardridhur,
Prekte muret,
Fshihej suvase.

Bishta sysh,
Si thumba grerëzash,
Më pickonin pëllëmbë,gjoks..

E mbylla.

Rrëze murit shtrirë
Shijoja erën e re të gëlqeres.
Por,ah,
Piskama e tullave te murrosura,

Vaj i nxehtë në vesh!

Romance

Gishtrinjë e mi
Relieveve të tua të përthyerat,
Harpë e përbotshme.

Mollëzat e mia
Nën pushet e tua të kadifta
Azgje s'i ndan nga flaka e zjarrit,

"Kapronjtë e honeve"

Nga ethet e ëmbëla të nënbrinjëve,
I rrëshqasin tri bulza uji
Kuturisin honeve të shpirtit,
Zaullijnë e kthejnë përmbys karpate,
Lodrojne qiellit te greminave,
kënaqësive,
Zbresin ultësirave ,

E, dalin...

Mbi lirishten e saj të vogël,të butë,
Të qetë si meshë para gungimit ,
Rrjedhin ,

Të dehura bashkohen në fille zmeraldesh,
Ndriçuar nga nje rreze e fshehur!

Aspak çudi

Dimri hyn me javë brenda pranverës,
Pranvera brenda dimrit,
Vera brenda vjeshtës
Vjeshta brenda verës

Asnjëra prej të katrave nuk i`a mbyll portën tjetrës,
Asnjëra prej të katrave nuk zemërohet,

Kanë frike se po nuk ruajtën fqinjësinë e mire,
Bota bëhet katrahurë!

Leter nga varret

Këtej është qetë
Luhet Moxart, Shubert

Grindje e zenka ,

Këtej,

Etje për kurrora e pushtet,
Kyçur e zhytur i kemi dhjete pash nen dhe
Por tymi juaj i qirinjve
Zbret mermereve si hije,
E grindje zenka
Trazohen, përzihen,
Zgjatën kokat korba mbi dërrasa
Shqyejnë rasa.

E,
Këtej,
Ka rregull,
Ligj

DHIMITER POJANAKU I KALON
FESTAT NË SHTEPI

Poeti i njohur shqiptar, Dhimitër Pojanaku, ka kaluar festat e fundvitit në shtëpi ! Dihet tashmë dobësia e poetit për familjen, Adelinen, bashkeshort-en dhe për femijet Eris dhe Pjer. Familja e poetit pati këtë vit edhe një anëtare të re, Zhuljanën, dashurinë e kurorëzuar të Pjerit! Veç dashurisë për familjen , mësohet kështu edhe dobësia e poetit për shtëpinë, ndonëse nuk është e krijuar prej tij thënia "shtëpi , e ëmbla shtëpi" ! Miqtë e poetit tregojnë se poeti nuk u është përgjigjur gjatë këtyre ditëve, telefonat-ave dhe as ka frekuentuar lokalet e preferuara! Nuk dihet nëse mbyllja në shtëpi ka patur shkak ndonjë prej tekave të Pojanakut, apo poeti ka qenë i përkush-tuar ndaj prozës, kur perflitet se së shpejti do çojë në botim një novelë me temë erotikë !

Anila ZAÇE

Me gollganat tona,
Kthyer ne çekiç,
I rifundosim
I rivarrosim,

Dhe përsëri qetë,
Luhet Mozart,
Shubert,

Këtej....

Lart, larg

Këtu ka vetëm ulla dhe pleq.

Ullinj të kohë pa shkundur
Pleqtë koha pa dashuri.

Era e detit ngjitet fshatit
Mbremjeve,
Sajon femije.

I fsheh nëpër guvat e ullinjve
Shtëpite e braktisura,
Dhe luajnë kukamfshehti.

E lodhur nga gënjeshtret e veta,
Era e detit futet fustanellave të plakave
Qemeret e hapur te pelqve

E tallit çka mbetur nga erotika.

Paqja
Këtu ,
Këndon këngë qyqesh!

Festë

Grisim qiejt për shami,

I grisim.

Rregjim lëkurën e maleve dhe u biemë daulleve
,e rregjim,u bjemë.
Shtyjme lumenjtë me pëllëmbë dhe kush nuk bindet
E thurpërojmë si kuajt,
I shtyjme,thurpërojmë,

Shkulim nga gjokset rrëshirat e vetmisë dhe
I zjemë në kazane ushtarësh,
I shkulim, i zjemë.

Ngordhim nervin e mërise dhe mbushim
Humnerat me amalgame,

Ngordhim,mbushim.

Hyjme llogoreve të luftës

Si të vilave korridore,

Kampet armike pajtojmë e pimë
pajtojmë e pimë,

E bamp,
E bump!
E tam,
E tum!

Koketa

Eshtë pema më e përkëdhelur e kopshtit,
Ka ca gjethe të vogla,si thonjtë e vegjël të grave,
Ngjyrë këna.

S`jep fruta!
Me kryneqësine
Mbulon shterpësinë.

Nga poshtë lëndine
Një sy drite,
Me marifet,
Aty i jep shkëlqim
Atje mister.

Vetëpërkëdhelet,
Vetëmiklohet.

Dimër e verë
Fsheh nëpër trup ca zilka çudibërëse
Që zemra ja lidh me hapat në rrugë

Dhe çdo udhëtar ,
Sa shkel klonin e saj,
Bien në grackë.

TË PËRKUJTOJME ME NDERIM PERSONALITETET E SHQUARA TË KOMBIT TONË

Gjergj Pekmezi, personalitet i shquar

Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë e 140 vjetorit të lindjes të Prof. Dr. Gjergj Pekmezi

Ky dorëshkrime është botuara në shtypin e kohës! Gazeta "Koha", e cila është gazeta më e vjetër në Shqipëri, me themelues Mihail Gramenon e Drejtor Koço Gramenon, Gazetë e paanëshme, politike, letrare, mbron të drejtat e popullit. Boton në Korçë e shtunë datën 6 shtator 1924 boton një intervistë ekspluzive të marë në Vienë më datën 23. 8. 1924. Dr Gj. Pekmezi, Konsullit të Shqipërisë. këtë dorëshkrim po e citoj më poshte:

Jetëshkrimi i Konsullit Prof.

Dr Gjergj Pekmezi!

Më 23 Prill të vitit 1872 ka lindur në Ohër. Babai Spiro Pekmezi ishte nga Tushemishti, nëna Dhespina Leshqar ishte nga qyteti i Ohrit. Të dy prindërit kanë vdekur. Jam rritur në Poradec, ku e mbarova dhe shkollën fillore, por rëndin e tretë të shkollës së mesme në gjuhën Greke e mbarova në Ohër. Mbas mbarimit të shkollës së mesme, punova dy vjet mësues në Llëngë. Mbas fitova e grumbullova ca para, shkova për studime në gjimnazin grek në Manastir të cilin e duke shërbyer e mbarova në Korrik të vitit 1890. Më pas shkova në Beligrad ku për 4 vjet mbarova studimet Theologjike dhe Pedagogjike. Në vitin 1894 erdha u regjistrova në Universitetin e Vienës duke punuar e vet në mënyrë autodidakte e private, studiova deri në vitin 1898 në Fakultetin e Filozofisë në radhë të parë degën e Gjuhësisë. Në gusht të vitit 1900, Akademia e Diturive të Vienës më nderoj, duke më dërguar me detyrë në një udhëtim në Shqipëri, Greqi dhe Maqedhoni, për të studiuar si gjuhën shqipe ashtu dhe gjëndjen politike. Në këtë udhëtim pati edhe të tjerë nga ana e Ministrisë së Austro - Hungarisë me detyrë për të shikuar se ç'farë veglash prej hekuri e tunxhi përdoren në këto vënde me qëllim që ti prodhojnë më pas në Bosnjë e më tej ti eksportojnë në këto vënde. Kur u ktheva nga ky udhëtim shërbimi, pregatita e shkrova dy raporte të gjatë mbi ato çështje, njëri raport u botua në gazetën e përkohëshme të Akademisë, raporti tjetra ndodhet në arkiv të ministrisë. Në vitin 1902 e dorzoza dizertacionin tim, mbi gjuhën shqipe me të cilin u aprovova me titullin Doktor Filozofie nga Universiteti i Vienës. Me përpjekjet e mia në vitin 1904 u çel katedra e gjuhës Shqipe në universitetin e Vienës. Kjo punë atëhere bëri bujë të madhe në Ballkan. Në institutin e përmendur oriental të Vienës, atje unë u emërova prej Ministrisë të Arsimit t' Austrisë, Profesor i gjuhës Shqipe. Në këtë kohë u emërova edhe në ministrinë e punëve të jashtme të Austro - Hungarisë zyrtar, ku jam marë më të shumtat e herës me punë konsullore e politike, veçanërisht me politikën e Shqipërisë. Unë isha i emëruar Ndhimtar i Referentit të Shqipërisë, por dhe inspektor i bursistave shqiptarë.

Si dhe për çdo gjë që i takon propogandës dhe punëve me Shqipërinë. të cilat kalonin në dorën time. Të tërë lëvizjet mbrënda e jashtë Shqipërisë në ato kohë të kalonte nëpërmjet dorës sime. Çdo politikan Shqiptar që ka ardhur në Vienë në radhë të parë vinte në shtëpinë time. Të tëra librat për botim për shkollat shqipe në Gëgnisht e Toskënisht ndreqeshin dhe shtypeshin me përkujdesien time.

Në vitin 1906 unë krijova këtu Shoqërinë "Dija". Për disa vjet unë isha edhe



Gjergj Pekmezi (ne rreth) me Bajram Currin, Jashar Erebare, etj. ne Viene, mes viteve 1918-1922)

Kryetari i shoqërisë "Dija". Kjo shoqëri shtypi kalendarë e shumë libra të tjera dhe më në fund gazetë "Vllazënia"

Në vitin 1908 doli në dritë Gramatika ime e gjuhës shqipe e cila pati fatin të pranohet edhe prej Mbretit të Austrisë në bibliotekën mbretërore (Fidel Comunion).

Përveç kësaj gramatike bashkëpunova e e shtypa një bibliografi shqipe, një gramatikë praktike shqip dhe disa shkrime të tjera të vogla. Sinvjet e përkëtheva ja ndreqa gabimet e rradhita dhe e shtypa Bletën e Mitkos.

Po në këtë vit u dërgova si *dragoman dhe ndihmëtar i civil i Komisarit të Austro - Hungarisë në Mamastir

Në vitin 1913 më dërgoi Ministria e Jashtme si dragoman e ndihmëtar i Delegatit të saj në Komisionin Internacional për të caktuar kufijtë e Shqipërisë jugore.

Unë isha i vetëmi në komision që dinte të fliste në gjuhën shqip e greqisht. Në këtë udhëtim jeta ime ishte në rrezik të madh Në vitin 1914 u dërgova si dragoman i parë i Ambasadës së Austro - Hungarisë në Durrës. Atje isha edhe mësonjësi i gjuhës shqipe i Mbretëreshës Sofi.

Kur hyri Esat Pasha me rebelët e tij në Durrës, në fillim desh të më vrasë e mbasi u largova, rebelët e Esatit m' i vuadhën të gjitha plaçat e shtëpisë. Në kohën e okupacionit të Shqipërisë prej ushtërisë Austro - Hungare, Unë në atë kohë isha Kryetar i komësisë letrare në Shkodër.

Prej komandës të kësaj ushtërie u emërova në prill të vitit 1917 drogman i parë i delegacionit shqiptar, kur ky del-

egacion shkoi te Mbreti i Austrisë.

Përpara katër vjetësh, pas inisiativës së qeverisë sonë të atëherëshme, dhashë dorëheqjen nga Ministria e Jashtme e Austrisë. Për shërbimin tim të mirë e të besës që kam kryer për shumë vjet edhe ndaj Kryetarit të sotëm të Republikës më akorduan titullin "Regierungsrat" që d. m. th Këshilltar i qeverisë dhe korespondent me Konsull General së klasës së dytë. Pasi dhashë dorëheqjen menjëherë u emërova Inspektor i bursistëve shqiptarë në Austri dhe pas disa muajve dhe Konsull i Shqipërisë.

Gjatë këtyre viteve, "Kurë ndonjë herë gjer më sot, nuk ka pasur ndonjë ankimin nga Ministria e Jashtme ndaj meje, apo nga ndonjë shqiptari i ndërshëm s'kam ndëgjuar.

Me mijëra shqiptarë e shqiptarka të sëmure, kanë gjetur shpëtim nëpërmjet

ndihmës së dorës time, apo nëpërmjet dorës së gruas seme.

Tregëtarëve që kanë ardhur këtu, pa pasur ndonjë fitim i kam ndihmuar aq sa kam mundur. Shumë herë, kam ngruhur e shkrehur shtëpinë për punët e Shqipërisë Me dëme shumë të mëdhaja. Një herë kur shkova me komisionin për të caktuar kufijtë e jugut, një tjetër herë kur shkova me komisionin në Manastir. Si dhe kur shkova si drogman në Durrës e prej andej në Shkodër e Vienë. Tani kam një mot mot që dua të kem një shtëpi edhe unë, një shtëpi si shokët e mij. Një shtëpi representative. Prandaj e prisha gjithë kapital tim dhe ndreqa një shtëpi në të cilën mundem të jetoj si përfaqësues shteti në një shtet të parparuar. Të kem mundësi të pres e të përcill cilindo me buzë të qeshur. Për shërbimet emija, si në rastin e kufijëve të jugut të Shqipërisë m'u dha nishani e titulli nga Mbreti i Italisë më 13. X. 1914 "Chavalier dell' ordine della korrona d'Italia"

Që përkëthehet : Urëdhëri Kalorës i Kurorës t'Italisë. Për shërbimet e mia si dragoman i ambasadës së Austrisë në Durrës më nderoi Mbreti Wiedi me nishanin "Chavalier de l'Aigle d' Albanie" e më nishanin "Grand officer de l'Aigle d' Albanie"

*Dragoman - përkëthyes.

Intervista marë në Vienë më 23-9-1924. Materiali i dërguar për botim Gazetës Mokra nga korespondenti jonë Koço Pihoni Marë nga monografia që po përgatitet për botim me rastin e 140 vjetorit të lindies

Gjergj Pekmezi, ishte filozof dhe filolog shqiptar. Lindi në Tushemisht të Pogradecit, më 23 prill 1872 dhe vdiq në Vjenë, më 24 shkurt 1938.

Studimet e para i kreu në Ohër e Manastir, kurse studimet e universitare i bëri në Beograd e në Vjenë, ku u diplomua më 1898 për filozofi dhe filologji. Më 1903 u emërua Shefi i Katedrës së Gjuhës shqipe në Universitetin Oriental të Vjenës. Pas një viti themeloi Shoqërinë Kulturore Patriotike "Dija". Më 1908 boton veprën monumentale "Gramatika e Gjuhës Shqipe", duke u bërë kështu gramatikanin e parë shqiptar. Pas kësaj në bashkëpunim me gjuhëtarë gjermanë, boton: "Bibliografia e Gjuhës Shqipe", "Udhëzuesi i Gjuhës Shqipe", "Libër Mësimi e Ushtrimesh në Gjuhën Shqipe", "Gjuha Shqip dhe Dialektet".

Do të dërgohet nga Akademia e Shkencave austro-hungareze në Shqipëri për qëllime studime ku do të hartojë monografinë në dorëshkrim "Tiparet dalluese thelbësore të dialekteve kryesore të shqipes, të toskërishtes dhe gegërishtes", një ndër studimet e para të dialektologjisë shqiptare dhe me vlera për këtë disiplinë. Do të pasohet me një punim tjetër "Raport provizor për studimin e së folmes së Elbasanit" (1901). Më 1908 do të botojë në Vjenë "Gramatikë e gjuhës shqipe" (gjermanisht), një ndër veprat më të mira të autorit dhe të gjuhësisë shqiptare për atë kohë. Këtu, ne mësojmë edhe disa mendime të autorit për gjuhën letrare, të cilat do t'i përsërisë edhe një vit më vonë në revistën "Diturija" të Mithat Frashërit që dilte në Selanik. Ndërsa më 1909 do të jetë bashkautor në botimin "Bibliografia shqiptare", duke hyrë kështu në historinë e bibliografisë sonë.

Më 1916 është Kryetar i "Komisës Letrare të Shkodrës", ku me Luigj Gurakuqin, Gjergj Fishtë, Ndre Mjedën e patriotët të tjerë bënë punë të mëdha për shkollat, gjuhën tonë dhe librat shqip. Më 1908 zbulon memorandumin e famshëm të 1878-ës që Vaso Pasha e Sami Frashëri i dërguan Kongresit të Berlinit. Në këto vite transkripton librin: "Bleta Shqiptare" të Thimi Mitkos.

Po kaq i madh është kontributi i tij si patriot dhe diplomat i Shqipërisë. Është i famshëm qëndrimi i tij në 1913, pranë Komisionit Ndërkombëtar të kufijve, ku me mençuri vërtetoi shqiptarësinë e trevave të jugut, kundër synimeve greke. Në vitet 1920-24 emërohet Konsull i Përgjithshëm i Shqipërisë pranë Republikës së Austrisë. Riemërohet në këtë detyrë më 1926-28, vit në të cilën emërohet profesor në Universitetin e Vjenës, Katedra e Gjuhës Shqipe. Këtë detyrë e kreu deri më 24 shkurt 1938, kur papritur vdiq.

Përveç veprave të lartpërmendura, ai ka mbledhur e dorëzuar 8177 faqe të daktilografuara me materiale e relacione të konjuse Austro-Hungarezë të Shkodrës, Prizrenit, Janinës, Stambollit, nxjerrë nga arkivi i Ministrisë të jashtme të Austro-Hungarisë.

Sot katedra e albanologjisë në Universitetin e Vjenës mban emrin "Prof. Dr. Gjergj Pekmezi".

Kufoma e Malit të Thatë

Nga Bedri BLOSHMI

Duhet të ketë qenë fundi i nëntorit ose fillimi i muajit dhjetor 1981-1982. Ishim në ferrin e Spaçit, kohë kur autoburgu vinte shumë shpesh dhe sillte të dënuar për krimi të ndryshme si: arratisje jashtë shtetit komunist të kapur në kufi apo të raportuar nga spiunët të cilët gjendeshin kudo dhe me shumicë; kishte të dënuar për agjitacion dhe propagandë. Në Spaç, autoburgu hapej vetëm pasi kishte hyrë brenda telave me gjemba dhe pasi ishte mbyllur porta e madhe me hekura të trasha. Policët ngjiteshin në autoburg, hiqnin kyçet nga prangat dhe zbrisnin të dënuarit. Kartelisti, një oficer me ngjyrë, vinte me një bllok në dorë, pasi lexonte emrat e të dënuarve i kalonte në revistë dhe pasi i kriponin me bar morash këto fytyra të zbardhura nga izolimi i gjatë u shkonin një të qethur më shumë se zero. Pastaj hapej porta tjetër (ajo e vogla, kështu e quanin) e të dënuarit e sapo ardhur përziheshin me ne. Takoheshim e i pyesnin nga ishin, sa vjet ishin dënuar e pasi bënim nga një kafe mundoheshim t'i qetësonim sado pak.

Autoburgu këtë radhë kishte sjellë dy djem të rinj që ishin shumë të hutuar e të frikësuar e shpesh mbi faqet e tyre të pavëna brisk akoma rridhnin lot. Ata ishin nga Pogradeci, Sabri Rakipi dhe Arben Pilinxhiu ishin dënuar i pari me 10 vjet burg dhe i dyti me 9 vjet burg. Sabriu ishte nipi i Avdulla Alarupit, naciaonalistit e luftëtarit të paepur kundër pushtuesit e Arbeni ishte kushëri i Sabriut, të dy, për moshën që kishin, ishin tepër të guximshëm. Sabriu kishte pasur babanë në burg të dënuar 10 vjet për agjitacion. Bisedat që kishte bërë me të atin në shtëpi pas lirimimit nga burgu, kishin pasur vlerë duke e orientuar Sabriun. Në mesin e dimrit kur bora kishte mbuluar gjithçka, Sabriu me Benin biseduan dhe vendosën të merrnin rrugën drejt kufirit në Malin e Thatë. Mirëpo këtë bisedë e dëgjoi edhe vëllai i vogël, Luli dhe iu lut që ta merrnin edhe



atë me vete. Sabriu me Benin fillimisht u munduan ta bindnin, duke i thënë se ishte i vogël e se nuk do të mund t'i rezistonte borës e acarit të malit të Thatë, por Luli këmbënguli dhe u tha se do të shkonte me ta edhe pse mund të ngrinte apo të vdiste në Malin e Thatë, po vetëm aty nuk donte të qëndronte më. Beni e Sabriu të zënë ngushtë dhe duke e ditur se Luli nuk do t'u ndahej ose më keq akoma do t'i ndiqte nga pas, vendosën ta marrin. Një natë me furtunë u nisën drejt lirisë edhe pse mund të vriteshin, ata nuk do të pendoheshin aspak, ishin të vendosur. Sapo morën përpjetë pllajës së Malit të Thatë, rruga u bë edhe më e vështirë e bora i pengonte të ecnin. Pas një cope rrugë Luli mbeti prapa. Era e fortë ua hidhte borën në fytyrë e herë njëri e herë tjetrin çanin përpara borën ashtu të lodhur e të heshtur pa thënë asnjë fjalë sepse rrezikonin të dëgjoreshin nga ushtarët dhe u hidhnin prangat. Në errësirën e furtunë Sabriu i tha me zë të ulët Benit: "Ore, Luli s'po dëgjohej, a është apo jo pas nesh?". Panë nëpër errësirë po nuk dalluan gjë. I thërritën po nuk morën asnjë përgjigje. Atëherë vendosën të kthe-

hen mbrast e pasi ecën pak e gjetën Lulin gati të ngrirë mbi borë. I folën, i fërkuan fytyrën, i matën pulsën dhe Beni tha se zemra i punonte. Më në fund Luli u përmend: "Vëlla e kaluam kufirin? Po qe se jemi larg, ju ikni se unë nuk mundem më. Më lini diku këtu dhe vazhdoni rrugën." Ecnin në errësirë ashtu të heshtur, herë duke e mbajtur njëri e herë duke e mbajtur tjetri Lulin mbi shpinë. Rruga sa vinte e vështirësohej e lodhja bëhej gjithnjë e më e madhe. Ata nuk dinin sa do të vazhdonin akoma të ecnin mes borë në errësirë të lagur, të uritur e të frikësuar. Ata nuk e dinin ku ishte kufiri, por edhe po ta dinin bora kishte mbuluar çdo shenjë. Era e tërbuar vazhdonte t'u përplaste si e marrë borën mbi fytyrë, por gjendje bëhej akoma më e vështirë sepse mbanin mbi shpinë Lulin. Ta linte vëllain në borën e Malit të Thatë? Po të vinin ushtarët e ta kapnin, do ta fusnin në burg, do ta torturonin e ai ishte i vogël e i parrahur me jetën. Ishte kurajoz, i dashur, i sjellshëm, i qeshur dhe u përpoq t'u shpëtonte telave me gjemba, por ja ku arriti. I ftohti e bora dalëngadalë po e ngrinin këtë vocërrak duke ia prerë në

mes dëshirën e ëndrrën për jetën. U ndalën diku të shploheshin pak, e ulën Lulin dhe i thanë: "Hë Luli, si je? Ja dhe pak, besoj se e kemi kaluar kufirin. Do të shkojmë në Amerikë ku kemi kushërinj të tanë e do të stabilizohemi shpejt. Meqë s'morën përgjigje nga Luli, Sabriu dhe Beni filluan t'i fërkonin faqet, t'i lëviznin duart, po asnjë shenjë. Beni vendosi veshin mbi kraharorin e Lulit, por rrahjet e zembrës nuk dëgjoreshin, nuk kishte asnjë tik-tak. Vendosi buzët mbi ballin e Lulit edhe ai akull i ftohtë. Zemra e Lulit nuk rrihte më. Pasi qanë një copë herë e morën Lulin përsëri mbi kuriz dhe vazhduan rrugën pa e ditur ku po shkonin. Përpara tyre u duk një gjë e zezë. U afruan më shumë dhe panë se ishte një shpellë. Sabriu e vendosi Lulin diku në një cep të shpellës dhe e mbuloi me xhupin e tij. Ia shtriu duart e këmbët, ndërsa sytë i kishte mbyllur vetë. Sabriu e Beni u plasën të dy mbi kufomën e ngrirë dhe shpërthyen në lot. Herë pas here goditnin kokën me grushte duke thirrur: "Pse na le o Luli në mesin e rrugës në ngricat e Malit të Thatë?". U ngritën të mbytur në lot duke i dhënë puthjen e lamtumirës Lulit: "Fati e deshi që të ndaheshim në këtë mënyrë. Ne s'do të të harrojmë kurrë o Luli i vockël. Askush nuk mendonte se do të na ndodhte kështu. Kjo nuk është dëshira jonë, fati deshi kështu, këtë kishte rezervuar fati për ty o vëlla. Të futëm në këtë shpellë, të mbuluar me teshat tona që të mos kesh më ftohtë. Mirë pra, o Luli ynë, po të lemë, por nuk do të të harrojmë kurrë. Të deshëm shumë e kur ishim bashkë loznim e qeshnim. Tani do të të duam edhe më shumë. Lamtumirë!".

Pasi ecën dhe pak u ndeshën me patrullën e ushtarëve që i çuan në postën e tyre dhe i lidhën më këmbë pas një cepi rruge. Me të mbërritur xhipi i çuan në Degën e Punëve të Brendshme të Pogradecit. Sabriu dhe Beni i thanë se ishin tre, por Luli... E sollën kufomën e Lulit mbi një makinë që e shëtiti nëpër qytet ashtu të ngrirë siç ishte dhe në spantin e makinës kishin shkruar: "Kështu do ta pësojnë të gjithë tradhtarët dhe armiqtë!".

Një histori që nuk e shuan as koha

Historia është një gjurmë e përjeteshme me të cilën njerëzit nuk mund të shkëputin lidhjen me të, për të ardhmen. Çdo gjë nuk mund të kuptohet apo shpjegohet jashtë historisë, prandaj kthejmë kokën pas dhe kujtojmë me admirim motshmërinë e thinjave të të parëve tanë. E tillë është edhe historia e familjes Hamza dhe Mersin Menkshi në fshatin Velçan të Mokrës.

Në vitin 1917, siç dihet, edhe ky fshat si e gjithë Mokra, u përfshi nga vorbullat e Luftës së Parë Botërore. Në thellësi të lumit Shkumbin, në vargmalet e Mokrës si kurrë më parë, banorët përjetuan dëbimin masiv, nëpër vendet e Ballkanit nga ushtia bullgare me në krye Car Ferdinandin. Gjatë këtij dëbimi tragjik, të shumtë ishin mokraret që mbetën të vdekur, pa varre, dhe varre pa emer në Ballkan. Këtu fillon historia e familjes se Hamza dhe Mersin Menkshi, dy vëllezër nga Velçani, të cilët po përgatiteshin për dëbimin që do ju behej nga ushtria bullgare. Karvani i mundimeve do te ishte i gjatë para nisjes në muhaxhir, prandaj Hamza Menkshi mori dy fem-

ijet e vëllait të tij, Mersinit, djalin Barjamin, 13 vjec dhe vajzen, Xhemilen, 18 vjeçe, për t'i lënë në fshatin më të afërt në Gramsh, pasi rrugëtimi në dëbim mund te ishte pa kthim, si dhe me mendimin se bullgaret nuk do kalonin malin e Gjemthit, ose Guri i Zi, si i thonë. Kjo "zgjedhje" ishte e menduar mirë, për të mos shuar derën e familjes, të paktën dy fëmijë duheshin shpëtuar. Hamzai mori rrugëtimin përtej malit të dendur me ahe dhe bredha dhe për orë të tëra eci, eci, për të arritur në fshatin Poroçan të Gramshit. Aty fati i drejtoi në familjen e Hasim Qefës, një familje me mirëpritje bujare dhe traditë shqiptare, e cila e priti në shtëpi Hamzain bashkë me dy fëmijet e vëllait. Hamza Menkshi i kërkoi një nder Hasim Qefës, që të mbante fëmijet, derisa ata të ktheheshin, me shpresën se debimi nuk do ishte i gjatë. Familja Qefa vendosi që t'i mbante fëmijet, derisa të qetësohej situata. Të nesërmen Hamzai u largua nga Poroçani, por me dhimbje të madhe në shpirt, për nipin dhe mbesën që i la në besën e Hasim dhe Qamile Qefës. Të dy këta bashkëshortë kishin katër djem Deme, Xhaferr, Nexhip dhe

Musa Qefa. Koha ecte dhe rrugëtimi i vështirë i dëbimit nga trojet e veta të familjes së Hamza dhe Mersin Menkshi vazhdonte. Pasi kaluan dy vjet dëbim, në 1919 kthehen në trojet e tyre, por, për fat të keq, gjithçka që lanë ishte shkumbuar, duke nisur ndërtimin e një kasoljeje me purteka dhe e lyster me baltë, sa për të futur familjen brenda. Mbas disa ditësh vendosën që Hamzai të shkojë në Poroçan me merakun e madh për të parë dhe për të marrë Barjamin dhe Xhemilen, nëse ishin gjallë dhe për të ditur fatin e tyre. Kur arriti në Poroçan pa te Xhaferr Qefa se nipi dhe mbesa ishin shëndoshë e mirë dhe të zotët e shtëpisë e pritën Hamzain plot bujari. Një familje fisnike e plot tradita. Të nesërmen Hamzai mori fëmijet për t'u larguar për në Velçan, por mirësjellja e djemeve Qefa, nuk qe vetëm mbajtja në shtëpi e fëmijeve. Xhaferr, Musai, Deme dhe Nexhipi, para se Hamzai të nisej, i nxorën një kalë dhe i dhanë edhe një kuintal grurë me fjalet se këto u takojnë fëmijeve, pasi kanë punuar, janë ushqyer e veshur, vetëm me forcën e tyre dhe kjo eshte djeresa e tyre. Mbasi u larguan për në Mokër Hamzai

me nipërit e tij, me familjen Qefa ngelen si vëllezër. Për ta ruajtur atë të mirë dhe për të mos e harruar kurrë këtë miqësi familjet e Menkshi dhe Qefa shkëmbejnë vizitat e tyre tradicionale dhe kjo traditë ka mbetur dhe po vazhdon edhe në ditët e sotme, një traditë e bukur që vazhdon të ruhet, pavarësisht se kanë kaluar 95 vjet dhe sipas levizjeve demografike, në drejtime te ndryshme, një pjese e qefanikëve kane ardhur në Mokër. Në fshatin Manastrec ndodhet goca e Xhaferr Qefës, e quajtur Selime me bashkeshortin e saj Njazi Hoxha, ndërsa djemtë e Musait, Dervishi ka zbritur në Zall-Torrë kurse Istrefi, Rizai, Bedriu dhe Qemali ndodhen në Elbasan. Këta, me djemtë e Serjan dhe Demir Menkshit e ruajmë edhe sot ate miqësi që i lanë prindërit dhe i kujtojmë me shumë respekt dhe dashuri Hamit dhe Qamile Qefën. Gjithashtu shprehin respekt për shumë e shumë emra të tjerë të fisit Qefa.

Ju shprehim mirënjohjet tona, me respekt nga nipërit e Hamza Menkshit: Hajdar, Barjam, Lutfi, Mersin, Hysen, Rexho, Bardhi, Hamza Menkshi. Mirënjohje te perzemta fisit Qefa.

PROMOVIMI I LIBRIT "SELCA E SIPËRME, MOKËR MONOGRAFI,, E AUTORIT DAUT KROI.

Selca e Sipërme me histori të shkruar

Nga Zenun FERRO.

Autori Daut Kroj, më 26 nëntor 2011, në qytetin e Pogradecit, promovoi librin "Selca e Sipërme, Mokër monografi,, shtypur në shtypshkronjën "Mirgeeralb,, Tiranë, nëntor 2011. Për këtë autori më ftoi, por në pamundësi për të shkruar e mora në telefon. Nga Shqoata "Pelioni" dhe nga stafi i gazetës "Mokra,, morën pjesë dhe folën Istref Haxhillari, Bujar Balliu, Koço Pihoni e të tjerë. Pas promovimit takojmë autorin, e urojmë për botimin e këtij libri. Dëshira e tij ishte të na dhuronte nga një libër, dhe këtë e bëri në një takim më 18 dhjetor 2011, në Tiranë, ku dhuroi disa libra për shoqatën "Pelioni" dhe stafin e gazetës "Mokra".


Autori Daut Kroj tregon se fillësën e librit "Selca e Sipërme, Mokër,, e kam nga libri juaj "Slabinja e Jonë", Tiranë 2005. Erdha u takova bisedova me zotin Kristaq Nanushi dhe shkëmbyem eksperiencë. Këtë mision autori Daut Kroj e realizoi në nëntor 2011, dhe thekson "Tani që librin e përfundova. Borxhin ua kisha ju, o gjaku im..! Selcë, dhuratë ja u solla!

Librin "Selca e Sipërme, Mokër e lexova me vëmendje dhe me ngadalë, për të njohur më mirë, fshatin "Selca e Sipërme. E vërtetë është se unë mësova shumë gjëra që nuk i dija. Mënyra e të shkruajturit, sinjerisht e hollësisht më bëri t,i bëj pyetje vetes? Paska punuar mirë autori Daut Kroj. Këto lloj librash, historike, monografi, duan, përkushtim, saktësi, kohë të madhe e tjera. Vetëm takimi me njerëzit, bisedat, marrja e fotografive, ishte dashur autorit me vite të tëra, rreth 5-6 vjet. Por dashuria për vendlindjen, këtë sakrificë të madhe autori e bëri dhe ia doli mbanë. Urime për këtë punë të lodhshme, suksese në punime të tjera.

Fshati "Selca e Sipërme, Mokër, ka histori të lashtë, banorët më parë kanë qënë e jetuar më poshtë dhe fshati i tyre quhej Remçidol. Nga faktorë të ndryshëm u shpërngulën, dhe disa ndërjuan shtëpitë e tyre më lart, në fshatin "Selca e Sipërme, Këtë e tregojnë dhe italianët nga Kalabria, në vitin 1940, kur ishin pushtues në Shqipëri dhe qëndronin në Selcë... Në një dhomë rrinin pesë ushtarë italianë, që flisnin shqip... Ata ishin kalabrezë dhe quheshin Fredi, Muhamet, Nevruz... Gjyshi i tyre i kish thënë se prejardhjen e kemi nga Albania nga fshati Remçidol, Mokra e Sipërme e Pogradecit. Fredi tha, se babai i tij kishte lindur në Remçidol. (Daut Kroj "Selca e Sipërme, Mokër,, faqe 121).

Nga mesi i shekullit 9-të bullgarët pushtuan Ohrin, Mokrën e deri Adriatik. Më vonë tokat e pushtuara shqiptare u zgjeruan dhe në vitin 976 dhe 1014 qendër e shtetit u bë Prespa e më vonë Ohri. Në Mokër, emrat sllavë viheshin zakonisht duke i përkthyer emrat e vendeve nga shqipja në sllavisht. Emri Selcë, ka kuptimin sllav-vend i vogël (fshat i vogël) (Zenun Ferro, gazeta "Mokra" Nr 3, viti 2002). Mokra nuk u asimilua nga pushtuesit sllavë, por disa emra i kanë. Ata nuk kanë prejardhje sllave, por janë vënë duke i emrat e vendeve shqipe në sllavisht. Qeveria e Zogut, më 6 korrik 1938 vendosi emertesat e reja gjeografike të qyteteve, lagjeve, fshatrave dhe fjalë Selcë e Sipërme-është emërtuar Katundi i Sipërm, (Gazeta "55,, datë 30 dhjetor 2004) Selca e Sipërme, në regjistrimet e qeverisë turke në vitin 1519, kishte 42 familje. Në vitin 1583 kishte 48 familje, pra ishte një fshat i plotë.

Fiset në këtë fshat kanë qënë 15, Ade-



maj, Boçka, Dushku, Fero, Gorica, Gozhdari, Guzi, Guxholli, Sadikaj, (Kroj), Ruçolli, Shaholli, Shtogu, Toska, Toto e Zyko. Janë nga fiset më të vjetra në Mokër, dhe kanë prejardhje nga vende të ndryshme.

Fisi Ademi, më i vjetri, më i hershmi, ndersa fisi Boçka ka ardhur më vonë se fisi Ademi. Fisi Dushku, ka ardhur nga fshati Homezh në vitin 1955, me profesionin kovaç (evgjit), fisi Fero ka ardhur nga Hudënisht, fisi Gorica nga kalaja e Pogradecit, Katjel e Goricë. Nga Anadolli ka ardhur fisi Gozhdari kanë qënë hekur punues dhe mbiemrin e parë e kane patur "Hallka" e më pas i kanë mbiquajtur Gozhdari. Fisi Guzi ka ardhur nga fshati Brozhdan i Gramshit në vitin 1850, ka ardhur një djalë i martuar në Selcë të Sipërme.

Fisi Guxholli ka ardhur nga Dibra e Madhe për grindjet që kanë pasur atje. Ndërsa fisi Sadikaj (Kroj) është fisi dytë pas fisit Ademi, ka ardhur nga Azia e vogël, emir Sadikaj turqisht do të thotë shërbëtor. (Daut Kroj "Selca e Sipërme, Mokër,, Tiranë 2011, faqe 216). Ishte Limi mikëpritës, i zoti i gojës, i binte edhe tamburasë, e gjente fjalën e duhur në momentin e duhur. Për gjithë këto cilësi ka qënë kryeplak i fshatit në kohën e mbretërisë së Zogut, dhe ka ndërruar mbiemrin nga Sadikaj në Kroj.

Fisi Ruçolli ka ardhur së bashku me fisin Toska rreth vitit 1800 nga Finiqi i Sarandës, të përzënë nga Ali Pashë Tepelena, i pari i këtij fisi është quajtur Ruço, prandaj dhe fisi ka marrë këtë mbiemër, Ruçolli. Ndërsa fisi Shaholli e ka origjinën nga Azia e Vogël nga Perisa, së bashku me fisin Sadikaj, kanë qënë i pari i sektit islam.

Fisi Shtogu mbijeton dhe merr emrin Zyko, nga i pari i tyre. Ndërsa fisi Toska ka ardhur nga Finiqi i Sarandës, të përzënë nga Ali Pashë Tepelena, rreth viteve 1800, kanë ardhur më vonë se fisi Gorica, Shaholli e Gozhdari. Ndërsa fisi Tato, një fis, që herët mund të ketë ardhur nga Ohri. (Daut Kroj "Selca e Sipërme, Mokër,, Tiranë 2011, faqe 321). Fshati "Selca e Sipërme, nga regjistrimet e vitit 1930 ka një rritje të banesave. Në vitin 1930 kishte 138 banorë, në vitin 1955 kishte 258 banorë. Selca është rritur, arsimuar, në vitin 1945 hapet shkolla fillore, në vitin 1962 shkolla tetë vjeçare.

E veçanta e këtij fshati është se në vitin 1982 hapet shkolla e mesme bujqësore, me nxënës nga Oshteca, Zemça e Homçani, dhe mbyllet në vitin 1994, (faqe 362)

Nga fshati Selca e Sipërme kanë mbaruar shkollën e Lartë rreth 16 djem e vajza,



inxhinierë pyjesh dy, ekonomistë pesë, agronomë katër, oficerë tre dhe për mësues dy. Këta djem e vajza kanë drejtuar, në Selcë, Pogradec, e Mokër.

Selca e Sipërme, ka qënë mbështetje e fuqishme e Luftës kundër fashistëve, nazistëve, mbështetje e forcave partizane, dhe komandantit të tyre, Reshit Çollaku .

Xha Veseli i (Selcës) që pat dëgjuar gjer në me vëmendje dhe hapi bisedën, foli: "Fjalë të bukura thatë, o djem, Ju lumtë! Ju hëngërt goja mjalte. (Nexhat Hyseni "Reshit Çollaku ,, Tiranë, viti 1964, faqe 50). Selca e Sipërme, dallohej për këngën e saj ku në konakët e saj këndohej e ngrihej dollia.

*Kënga vazhdonte
Zbret lulja nëpër dëborë
Me një trandafil në dorë
Nëma mua trëndafilë!
Unë ta jap, po s' më lë nëna*

Këto lloj librash, historike, monografi, duan, përkushtim, saktësi, kohë të madhe e tjera. Vetëm takimi me njerëzit, bisedat, marrja e fotografive, ishte dashur autorit me vite të tëra, rreth 5-6 vjet. Por dashuria për vendlindjen, këtë sakrificë të madhe autori e bëri dhe ia doli mbanë. Urime për këtë punë të lodhshme, suksese në punime të tjera.



LIBRAZHD: MATURANTËT E POLISIT, ÇMIM TË PARË NË FOLKUN EUROPIAN ZHVILLUAR NË TURQI

Maturantët e gjimnazit të Polisit, komunës me të njëjtin emër të rrethit Librazhd, kanë fituar çmim të parë në Konkursin e Folkut Europian të zhvilluar në Turqi. Një grup maturantësh, të cilët shquhen për talentin e tyre në mjaft fusha të artit, me mbështetjen e Qendrës së Kulturës së Librazhdit morën pjesë në aktivitetin ndërkombëtar të Folkut të Traditës, që u zhvillua në pjesën aziatike të Turqisë. "Në këtë aktivitet, artistët gjimnazistë të fshatit Polis prezantuan denjësisht vendin tonë përballë 48 konkurruesve të tjerë nga shtete të ndryshme me traditë në kul-

*Po nënën e gënjej unë,
E gënjej e ve në gjumë
(Tomorr Starova "Këngë popullore nga rrethi i Pogradecit,, Tiranë 1987, faqe 172)*

Një këngë e vjetër, që në kohën e pushtuesit turk këndohej në Selcë dhe ja se çfarë thotë:

*Na erdhi një letër, o një lajm i zi,
Shokë me aman shokë me oi,
Na kërkohet askerë, të shkojnë në Turqi,
Do të lemë gratë, do lemë fëmi,
E nuk është pak, po është dhjetë vjet,
Do shkojmë të ri, do kthehemi pleq,
Do shkojmë të tërë e do vimë një çerek*

(Tomorr Starova "Këngë popullore nga rrethi i Pogradecit,, Tiranë 1987, faqe 373).

Mungesa e infrastrukturës pas vitit 1990-të, ka bërë që emigrimi e migrimi të zvogëlojnë, sa në vitin 2010, Selca e Sipërme, kishte vetem 10 familje, me 70 banorë, nga të cilët 32 meshkuj dhe 38 femra. Shkolla 9 vjeçare kishte 52 nxënës dhe 4 mësues. Prej fshatit tonë janë vetëm 15 nxënës, të cilët 9 në shkollën fillore.... Kjo është gjëndja e Selcës. (Daut Kroj "Selca e Sipërme, Mokër,, Tiranë 2011, faqe 374).

Djemtë dhe vajzat e Selcës, janë larguar fizikisht nga vendlindja, por zemren e kanë atje. Edhe autori Daut Kroj, u largua i vogël, por u kthye, i cili beri monumentin e saj, librin

"Selca e Sipërme, Mokër,, . Të gjithë brezat aty do të gjejnë gjenezën, historinë, traditat e vendlindjes së tyre, me këtë rast, i uroi autorit suksese, dhe libra të tjera.